Sherr me armë mes disa personave te ish-Parku i Autobusëve në Tiranë, 2 të plagosur, njëri prej tyre me precedent për shpërndarje droge! Identifikohen autorët

Dy të rinj, Aleksander Nikolli, mëth 27 vjeç dhe Xhulio Vela, mëth 25 vjeç, kanë mbetur të plagosur nga të shtënat me armë zjarri në zonën e njohur si ish-Parku i Autobusëve në Tiranë.

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
13 Tetor, 17:10 | Përditësimi i fundit: 13 Tetor, 21:50

TIRANË- Dy të rinj kanë mbetur të plagosur nga të shtënat me armë zjarri në zonën e njohur si ish-Parku i Autobusëve në Tiranë, pas një sherri. Ngjarja ka ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Ndre Mjeda" dhe "Frosina Plaku", ku Aleksander Nikolli, mëth 27 vjeç dhe Xhulio Vela, mëth 25 vjeç, kanë mbetur të plagosur nga të shtënat me armë zjarri.

Burime për gazetarin e Report Tv, Sokol Dema, bëjnë me dije se ka pasur një konflikt fillimisht verbal mes dy të plagosurve dhe autorëve, jamë një berberhaneje në afërsi të zonës. Më pas konflikti ka degjeneruar në përdorimin e armëve të zjarrit. Dy të rinjtë, të cilët kanë mbetur të plagosur janë dërguar në spital dhe janë nën kujdesin e mjekëve.

LEXO EDHE:
Ekspozita e piktorit Ismail Lulani, prezantohet për herë të parë në Muzeun Historik Kombëtar

Katër apo pesë persona kanë qenë pjesë e sherrit, dhe paraprakisht dyshohet se të gjithë njiheshin me njëri tjetrin dhe se kishin miqësi mes tyre. Mësohet se Xhulio Vela është me precedent penal në Shqipëri dhe në Itali, për shpërndarje droge. Policia ka identifikuar autorët dhe po punon për kapjen e tyre.

> *Rreth orës 17:00, në kryqëzimin e rrugës "Ndre Mjeda" dhe "Frosina Plaku", në rrethana ende të paqarta, janë plagosur dyshohet me armë zjarri shtetasit A. N., mëth 27 vjeç dhe Xh. V. mëth 25 vjeç, të cilët ndodhen në spital, nën kujdesin e mjekëve. Sherbimet e Policisë kanë ngritur pika kontrolli dhe po bëjnë kontrollin e zonës përreth vendit të ngjarjes, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit. Njëkohësisht, grupi hetimor po punon për mbledhjen e të gjitha provave që do çojnë në identifikimin e autorit dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes.*[1] *njofton policia.*

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:05
Një nga të plagosurit tek ish-parku i Autobusëve, me precedent penal për shpërndarje droge në Itali e Shqipëri

Një nga të plagosurit me armë zjarri tek ish-Parku i Autobusëve rezulton me precedent penal në Shqipëri dhe në Itali Për shpërndarje droge. Xhulio Vela, një vit më parë u kap në Itali për shpërndarje marijuanë.

Ora 17:40
Të shtënat me armë te ish-Parku i Autobusëve, zbardhen emrat e të plagosurve

Report Tv ka zbardhur emrat e dy personave të plagosur sot te ish-Parku i Autobusëve. Të plagosur janë Aleksander Nikolli dhe Xhulio Vela.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | te shtena me armE | plagosje me armE zjarri | ish-parku i autobusEve | aleksander nikolli | xhulio vela

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM
Sondazhi i ditës:
Propozimi i PD-së, a besoni se do të bëhet vettingu i politikanëve?
Po | Jo | Nuk e di
Komento

Lajme të tjera

Sociale

Tirana me ujësjellës të ri: Selitës, Shën Mërisë dhe Bovillës i shtohet edhe burimi i Gurit të Bardhë
19 Tetor, 14:05

Kronikë

Tiranë/ E zuri korrenti teksa po punonte, përfundon në spital elektricisti 55-vjeçar
19 Tetor, 12:14

Analiza

Rënia e narrativës narciziste të Albinëve në Prishtinë e në Tiranë
19 Tetor, 12:04

Sociale

Shoqata e Transportit Urban: Do vijojmë të operojmë me 50% të kapaciteteve, po falimentojmë! Institucionet shtetërore po neglizhojnë kërkesat tona
19 Tetor, 11:12

Kronikë

Sot në mbrëmje devijohet trafiku në Unazën e Re, shkak punimet në rrugë (HARTA)
19 Tetor, 08:45

Kronikë

Kryehetuesi i Rusisë merr në dorë çështjen! Misteret e vdekjes në Qerret të 4 turistëve, trupat i tërheq djali i familjes
19 Tetor, 08:29

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje